

fakte

Keqpërdorimi dhe lënja pas dore e fëmijëve

Çdokund lajmërohet për fëmijëvrasës, gjyrtim, lënje dhe forma të tjera fizike dhe seksuale të dhunës ndaj fëmijëve. Keqpërdorimi i fëmijëve është problem i përgjithshëm që është i thellë i hyrë në praktien kulturore, ekonomike dhe shoqërore.

SHKALLA E PROBLEMIT

- Vlerësohet se në vitin 2000, 57 000 fëmijë ishin viktimë e vrasjeve. Megjithatë, shumë vdekje të fëmijëve nuk hulumtohen në mënyrë rutine e as që tek ata nuk bëhet autopsi gjë me të cilën bëhet më e vështirë njohja e së vërtetës për shkallën e problemit.
- Shkalla më e lartë e keqpërdorimit fatal të fëmijëve është gjetur të fëmijët e moshës 0-4 vjeçare. Shkaku më i shpeshtë i vdekjes është lëndimi i kokës, me çka pasojnë lëndimet abdomenale si dhe ngulfatja me qëllim.
- Vdekshmëritë janë vetëm një pjesë e dukshme e problemit. Miliona fëmijë janë viktimë e keqpërdorimit jofatal dhe lënje pas dore. Në disa studime, në mes një të katërtës dhe gjysmës së fëmijëve paraqesin keqpërdorime të rënda dhe të shpeshta fizike, ku hynë të rrahurit, shqelmimet ose lidhje nga ana e prindërve.
- Të dhënat në dispozicion sygjerojnë se 20% të grave dhe 5-10% të burave kanë qenë seksualisht të maltretuar si fëmij.
- Poashtu edhe në shkollë dhe në institucione të tjera ka dënime të ashpra, më të shpeshta janë në formë të të mëshuarit, grushtimit, shqelmime dhe të rrahurit.
- Shumë fëmijë janë objekt i maltretimit psikik dhe emocional, si dhe i lënies pas dore edhe pse shkalla e vërtetë e këtyre problemeve nuk është e njohur.

PASOJAT NGA KEQPËRDORIMI DHE LËNIA PAS DORE

Shëndeti i ligë i shkaktuar nga keqpërdorimi përbën pjesë të rëndësishme të sëmundjeve globale. Përveç lëndimeve fizike si të gërvishurat, të nxirat, të djegurit, përvëliment, shkyerjet dhe thyerjet, maltretimi i fëmijëve lidhet edhe me numër të madh të pasojave tjera, përshirë këtu edhe:

- keqpërdorimi i drogës dhe alkoolit,
- pengesat kognitive dhe ngecje në zhvillim,
- sjellje delikvente, të dhunshme dhe të rrezikshme,
- çregullim në ushqim dhe në gjumë,
- rezultate të dobëta shkollore,
- marrëdhënie të këqija,
- probleme me shëndetin riproduktiv,
- çregullime post-traumatike stresore,
- depresion dhe ankiozitet,
- Tentim për vetëvrasje dhe vetëlëndim.

Shumë nga këto probleme, si rikthimi risin gjasat për sëmundje të mundshme të disa formave kryesore tek të rriturit.

KUSH JANË FAKTORËT-RREZIK PËR KEQPËRDORIMIN E FËMIJËVE

Hulumtimet tregojnë disa karakteristika të fëmijut dhe prindit si dhe pasqyrën e mjedisit familjar, me keqpërdorimin dhe lënien pas dore të fëmijëve.

Plaga e keqpërdorimit, qoftë ajo fizike, seksuale ose atë të lënies pas dore, pjesërishtë mvaret nga moshja dhe gjinia e fëmijut. Fëmijët e vegjël i janë më tepër të nënshtruar rrezikut të maltretimit fizik, kurse shkalla më e lartë e keqpërdorimit seksual është vërtetuar tek fëmijët që kanë hyrë në pubertet ose adoleshencë.

Në më shumë vende, djemtë janë më së shpeshti viktimë e të rrahurit dhe dënimit fizik, kurse vajzat durojnë rrezikun më të madhë nga bijëvrasja, keqpërdorim seksual, prostitucion të dhunshëm dhe ndalesa për edukim dhe te ushqyerit. Në përgjithësi, më tepër se 130 milion fëmijë në moshën ndërmjet 6 dhe 11 vjeç nuk janë në shkollë, prej të cilëve 60% janë vajza.

Faktorë tjerë që e rrisin mundësin e keqpërdorimit tek fëmijët janë:

- edukata nga ana e prindit vetëushqyes, ose nga ana prindërve shumë të rri pa mbështetje të familjes më të gjërë,
- amvisëri shumë antarëshe,
- mos pasja e të ardhurave për kënaqjen e nevojave familjare,
- prezenca e mardhënieve tjera të dhunshme në shtëpi.



Organizata
botërore
e shëndetësisë



Ministria e
shëndetsis, RM



Enti Republikan
për mbrojtje
shëndetsore



Fondacioni Instituti i
Hapur i Shoqëris Civile
në Maqedoni



Shoqata për emancipim,
solidaritë dhe barazi
gjinore në RM



Prindërit me mundësi më të mëdha për keqpërdorim të fëmijëve të tyre thjeshtë kanë vetërespekt të ulët, kontroll të dobët të impulseve të tyre, probleme me shëndetin mental dhe tregojnë sjellje antisociale. Ata zakonisht kanë pritje joreale në lidhje me zhvillimin e fëmijut.

Hulumtimet tregojnë se keqpërdorimi i fëmijve është më i mundshëm në shoqëri ku shkalla e varfërisë është e lartë, dhe me më pak rrjete sociale dhe sisteme për përkrahje fqinjësore që mbrojnë fëmijët.

ÇKA MUND TË BËHET QË TË PARANDALOHET KEQPËRDORIMI DHE LËNIA PAS DORE E FËMIJËVE?

Disa nga përgjigjet më efektive për luftën kundër keqpërdorimit dhe lënies pas dore të fëmijëve janë të koncentruara në ngritjen e fëmijëve, në mardhëniet prindë-fëmijë dhe mjedisin familjar, duke përfshirë:

- Trajnim për prindër: informim i prindërve për zhvillimin e fëmijës, poashtu edhe për besnikërin dhe lidhshmërin, si dhe mësimin e tyre se si të shfrytëzojnë metodat edukative dhe si të kontrollojnë konfliktin familjar,
- Programe me vizita shtëpiake: këtu hyjnë vizita të rregullta nga motra medicinale ose puntorë tjerë shëndetësor në shtëpinë e familjeve me nevoja speciale për përkrahje rreth përkujdesit për fëmijët, ose atje ku egziston reziku për maltretimin e tyre. Intervenimet mund të pëmbajnë këshillime, trajnime dhe udhëzime për në specialist ose agjenci tjera.

Megjithatë, programet që mw sw pari fokusohen në ruajtjen e familjes pa i trajtur thelbësisht arsyet që janë më pak efektive. Ata që përfshinë shkallë të lartë të pjesmarjes, duke përdorur metodin që mbindërton forcat e familjes dhe përfshinë elementet e përkrahjes sociale, duket se prodhojnë rezultate më të mira nga ata pa kompetenca të tilla.

Punwtorët shëndetësorë kanë rolë kryesorë në zbulimin, trajtimin dhe udhëzim të rasteve të keqpërdorimit dhe lënies pas dore, poashtu edhe në paraqitjen e dyshimit për maltretim deri tek instancat përkatëse. Për ta lehtësuar zbulimin dhe paraqitjen e rasteve, organizata të shumta shëndetësore zhvilluan programe adekuate për trajnim.

Derisa vlersimet e këtyre programeve tregojnë përmirsim në njohuritë e puntorëve shëndetësorë për keqpërdorim dhe lënie pas dore të fëmijëve, nuk dihet cili është ndikimi i programeve për trajnim ndaj rezultateve tjera, si p.sh., mbrojtje e përmirësuar dhe udhëzim i fëmijëve.

Qasje tjera për preventim të keqpërdorimit dhe lënies pas dore, fokusohen në:

- terapi dhe shërbime tjera për fëmijë që kanë qenë dëshmitarë ose kanë përjetuar maltretim,
- programe terapike për kryerësit,
- masa juridike si burgim, ndjekje, shërbime për mbrojtjen e fëmijve dhe sisteme për informim vullnetar dhe të patjetërsueshëm që do të ndihmojnë në zbulimin e rasteve të keqpërdorimit.

Të dhënat e deri tanishme për efektivitetin e këtyre metodave janë shumë të kufizuara. Vlerësimi adekuat nuk u është bërë për të shumtat.

Më së shumti shfrytëzohen iniciativat të bazuara në bashkësinë që të adresohet problemi. Derisa disa janë shkollore (trajnimi i fëmijve se si ta njohin situatën kërcnuese dhe mësimi i tyre me shkathtësi për mbrojtje nga keqpërdorimi), tjerët përfshijnë bashkpunim të shumë sektorëve për ngritjen e njohurive, të vetëdijes, poashtu edhe për përmirsimin e shërbimeve.

U përdorën edhe mediumet dhe lloje tjera të fushatave preventive që të stimulohet veprimi i shoqërisë dhe që të ndërrohen modelet e sjelljes.

Në nivel të shoqërisë mundw që të bëhet shumë që të preventohet keqpërdorimi dhe lënia pas dore e fëmijëve. Këtu përfshihen edhe masat për ballafaqim me varfërinë, për përmirsimin e arsimimit dhe mundësive për punësim, poashtu edhe për rritjen e disponueshmërisë dhe kualitetit të mbrojtjes së fëmijëve. Këto përmasa kanë potencialin që të barazojnë situatën e pabarazisë sociale dhe ekonomike dhe ti përmirësojnë rezultatet në favor të fëmijëve.